Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Postarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguame

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

NEDELJNI LIST
FLETORE E PERJAVESHME

Redaksia: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 38

PAJTIMET:
per 1 vjet 96 din.
„ 6 muaj 48 „
„ 3 muaj 24 „

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik
Drejtori pergjegjes XHELADIN HANA

Vjeti IV Nr. 110 | PRISHTINE, 16 Prill 1948 | Cmimi 2 dinarë

Trevjetori i nenshkrimit te Paktit te miqesis me Bashkimin Sovjetik

RRNOFTE VLLAZNIMI DHE MIQESIJA NDERMJET POPUJVE TE JUGOSLLAVIS E BASHKIMIT SOVJETIK

Me 11 prill 1945, kur popujt t'one, krah per krah me Armaten Sovjetike, shlirojshin definitivisht Vendin t'one nga okupatoret fashista, Marshali Tito nenshkroi ne Moske Paktin mbi miqsin dhe ndihmen reciproke ndermjet popujve te Jugosllavis e Bashkimit Sovjetik. Me ket Pakt u-realizuen definitivisht aspiratat shekullore te popujve t'one. Prandaj kjo dite ka qene per popujt t'one dite e gezimit dhe e krenaris se madhe, dite e garancis s'ardhmenis se Vendit t'one. Popujt t'one prej dashunis dhe besimit shum te madh ne Bashkimin Sovjetik, nga lufta e tij e vendosun, nga ndihma materjale e morale qe ka dhane çprej dites se pare te kryengritjes, — kane usjerre fuqi e besim ne vetvehte per perpjekje mbinjerzore, neper te cilat kaluen gjate viteve te betejave heroike, te vuejtjeve dhe fitoreve te luftes Nacjonal—Çlirimtare.

Popujt t'one e dijne se e vetmja rruge e drejte e zhvillimit t'one te matutjeshem dhe e ardhmenis se sigurte asht miqsija e forte dhe vllaznimi me Bashkimin Sovjetik. Okupatori fashist u-perpoq me na zhduke dhe na e dijme se qellimi i tij do t'ishte realizue sikur ne mburojen e liris se popujve sllav dhe te te gjithe popujve demokratik te mos ishte gjete Bashkimi Sovjetik, qe dha per ket liri sakrifica ma te mdhaja, dhe, sikur popujt t'one te mos ishin çue ne lufte per ekzistencen dhe jeten ma te mire te tyne.

Mik e vlla na qe BRSS ne diten e luftes mbinjerzore, ne periudhen ma te veshtire te historis s'one — mik e vlla na mbeti edhe ne paqe. Dhe per çdo vjet kjo miqsi e vllazni ndermjet popujve t'one dhe te Bashkimit Sovjetik po bahet ma e thelle e ma konkrete. Ndihma vllaznore qe u asht dhane popujve t'one iq me emer e pakursim ne periudhen e luftes çlirimtare, vazhdoi edhe ne ditet e rindertimit e ndertimit, vazhdon edhe sot ne periudhen e realizimit te Planit t'one te parë pesvjeçar.

Popujt t'one e dijne se, vetem te lidhun ngushtesisht me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe me popujt tjere sllave e te demokracis se re popullore, munden me u-zhvillue lirisht dhe pa u-pengue dhe kurr ma nuk do te jene loje ne duer te hueja. Vendi i madh i Socjalizmit, i cili gjate luftes se dyte botnore qe pishtar i luftes per çlirimin e te gjithe popujve nga agresoret fashista, mbas luftes u-ba shtylla ma e sigurte dhe ma e forte e paqes, pamvarsis dhe perparimit te te gjithe popujve. Mprojtja dhe perkrahja e kerkesave t'ona te drejta ne te gjitha konferencat nderkombetare, paraqitja e perbashket e perfaqesuesave te Bashkimit Sovjetik me perfaqesuesat t'one ne forumet nderkombetare ne lidhje me te gjitha çashtjet e mprojtjes s'interesave te paqes e demokracis, — e kane dishmue ma se miri dashunin dhe besimin t'one me vend ndaj Bashkimit Sovjetik.

Pakti i jone me Bashkimin Sovjetik, mandej paktet me Polonin, Cekosllovakin, Shqipnin, Bullgarin, Rumanin dhe Hungarin, qe u-nenshkruen mbas ktij, si dhe paktet qe kane nenshkrue keto vende njeni me tjetrin, kane qene kontribut i madh per paqen e demokracin ne bote. Bash ngjarjet qe po ndodhin sot ne bote jane dishmi se rruga, te cilen e ka zgjedhe Jugosllavija dhe vendet tjera t'Europes Lindore — rruge e mbeshtetjes se forte ne Bashkimin Sovjetik, — ka qene vertete e vetmja rruge e mundeshme.

Derisa ne Prendim t'Europes dhe ne shum vende te tjera te botes zhvillohet proçes i vazhdueshem dhe i dituushem i robnimit te popujve, dikur te pamvarun, e tash te lidhun me planin Marshall, derisa po zbatohet rrebte pengimi i zhvillimit te tyne ekonomik, kultural e politik, ne lindje t'Europes republikat e çlirueme demokratike popullore, te mbeshtetuna ngultazi ne Bashkimin Sovjetik, fare te pamvaruna ekonomikisht e politikisht, gjinden ne jehonen e plote te luftes se pergjithshme popullore per likuidimin e mbrapambetjes kulturore dhe ekonomike.

Pjesa e kesaj te vertete te madhe, sado qe te mos u pelqejne grabitçarve imperjalista, po depertoη ne menyre te pandalueshme deri ne skajet ma te largeta e ma te robnueme te botes. Popujt e vendeve te robnueme shofin se ne vendet e tyne e, edhe ne vendet e atyne qe u japin ndihme vetem per t'i robnue, mbretnon atmosfere e friges per jeten dhe sigurin, mbretnon halli per te nesermen, urija e papunsija; atje niveli kultural i jetes ulet dita dites e ne vendet e Europes lindore ndigjohen ushtimat e hapave vigane te njerezve te mundit, te cilet me duer te pervjeluna, pa brenga e frige per pamvarsi, ndertojne jeten e denje njerzore.

Ne sukseset e popujve te Bashkimit Sovjetik per kryemjen e detyrave te Pjatiletkes Stalinjane te mbasluftes, n'autoritetin per here ma te madh nderkombetar qe po gezon Bashkimi Sovjetik, ne sukseset e reja te kultures sovjetike, — popujt e Jugosllavis shofin suksesit e tyne, fitoret e tyne, sepse ato, vetvetiu, jane garancija ma e madhe per zhvillimin e tyne te matutjeshem te lire e te pa-penguesherm.

E. tue mesue nga eksperiencat me te cilat njerzit sovjetik punojne per realizimin e detyrave te mdhaja Stalinjane, popujt t'one, tue realizue planin e tyne pesevjeçar, formojne pamevaresin e tyne ekonomike dhe fuqin mprojtese te Vendit.

Popujt e Jugosllavis krenohen dhe jane te lumtun qe gjinden ne kampin e fuqishem anti-imperialist, ne mburojen e paqes dhe te demokracis, e qe me Bashkimin Sovjetik, ne balle te ketij kampi, jane te bashkuem pazgjidhmenisht me maredhanje vllaznore e miqesore.

Para konferences se II Krahinore te Frontit antifashist te grave te Kosmetit

Ne saje te punes se vetmohueshme, grate e Krahines s'one, si para Kongresit te II te Grave te Jugosllavis, qe u-mbajt ne kallnuer ne Beograd, ashtu dhe mbas tij, kane korre suksese te dukshme.

Fille mbas tij, me 11 fruer, u-mbajt plenumi Krahinuer i Grues antifashiste ne Prishtine me qellim qe te zhduken te metat e çfaquna ne vitin e kalnem, te paraqiten detyret e reja, te shtohen forcat per te korre sa ma shum suksese ne dobin e popujve dhe te Vendit t'one.

Delegatet e rretheve dhe te qyteteve, tue e pase kuptue mire randesin e detyrave qe kongresi i II-te na kishte parashtrue te gjitha organizatave antifashiste te grave t'ona, me te kthyem nga plenumi nder vendet e veta, u-perpoqen, u-keshilluen me shoqet e tyne qytetare dhe katundare dhe, te gjitha se bashku, i pranuen detyret e reja, shtrue nga Kongresi dhe shoku Tito. Ata mbrenda kesaj periudhe u-perpoqen me mish e me shpirte per t'i zhduke te metat dhe me i krye detyret e reja sa ma me perpikni. Mbrenda kesaj kohe jane krijue kushte ma te favorshme dhe u jane dhane mundesina ma te mdha femnave t'ona me marre pjese ne prodhim e sektore tjera pune, ne pershtatmeni me fuqit e veta fizike.

Ato ne shum vende kane formue kooperativa zejtare te veçanta, si rrobaqepsina etj., i kane permirsue kushtet ekonomike te tyne dhe te familjeve te veta e, njikohsisht, kontribuojne per ndertimin e jetes se re n'interesin e popullit puntuer.

Grate shqiptare, tue e kuptue randesin dhe ndi nevojen per shlirimin e tyne te plote nga robnija e çarshafit, dita dites po e hjedhin poshte ate dhe po bash koben me shoqet perparimtare te mbare Jugosllavis se re. Suksesi ma i afert ne kete fushe veprimi ka qene me 8 Mars, ku 1321 femna shqiptare te Krahines s'one e hoqen çarshafin. Ne kete menyre, ato, bashke me te tjerat qe me kohe jane dlire nga ai zakon mbrapanik, marrin fryme lirisht dhe e shijojne jeten e re ne Jugosllavin demokratike, me te drejta te plota dhe te barabarta si te gjithe qytetaret tjere.

Mbrenda kesaj periudhe asht shtue edhe ma fort interesimi i nji pjese te mire te grave per arsim dhe kulture. Ato tue e pasun kuptue dhe çmue mire rolin e arsimit, jo vetem qe jane nxite me i dergue femijt e tyne, djelm e vajza, ne shkolle, por edhe vete kane marre pjese nder kurse analfabetike dhe asosh te nalta arsimore. Mjaft prej tyne kane mesue te shkruejne e te kendojne mire. Kjo provohet edhe tash ne kohen e fundit me rastin e provimeve.

Ato nuk jane kursye t'i ndihmojne me gjana ushqimore dhe vesh mbathje shtepijat e femijve dhe internatet e shkollave te mesme te Krahines s'one.

Per forcimin e organizates se Grues Antifashiste, per zhvillimin e grave dhe per permirsimin e kushteve te tyne ekonomike dhe te familjeve te veta, Keshilli antifashist i Grave te Kosmetit, ndermjet datave 11 fruer dites se plenumit krahinuer, dhe 17 e 18 te ketij muaji-diteve te mbajtjes se Konferencas se II-te Krahinoreka organizue dhe hape kursin njimujuer per sektoret e keshillave te rretheve te F. A. G.-es dhe ka ba qe te mbahen seminare dhetedithse per udheheqset e seksjoneve t'ekonomis. Tash shpejte do te filloje edhe kursi njimujuer per aktivistet shqiptare. Me te ketilla suksese e me plot te tjera, grate e Krahines s'one do te marrin pjese ne Konferencen e II-te Krahinore dhe ma vone ne Kongresin e II-te te Serbis.

Randesin ma te madhe per forcimin politik t'organizates se Grues s'one, e kane zgjedhjet demokratike t'udheheqsinave te saje. Ne keto votime jane shtue me disa dheta mija antaresh te reja ne rradhet e ksaj organizate. Jane krijue organizata edhe nder ato vise ku nuk kane egzistue deri tash. S'duhet te kete mbete jashte rradheve t'organizates se Grues asnji femen e ndershme dhe qe e dishron perparimin.

Tue u-bazue ne Statutin e Grues Antifashiste, ne votimet e kalueme jane zgjedhe per udheheqse nder organet e organizates se Grues shoqet ma te mira, ma koshjente dhe ma te vetmohueshme. Asht permiresue kudo permbajtja kombtare e keshillave te grave, ku deri tash shqiptaret nuk kane marre pjese aq sa duhet.

Vetem keshtu dhe tue iu perveshe me seriozitet kryemjes se detyreve qe i ka parashtrue Kongresi i II i Grave te Jugosllavis dhe shoku Tito, grate e Krahines s'one do te muejne me kontribue sa ma shum ne permiresimin e jetes se re.

Ndihma per Permendoren e deshmoreve te luftes N. Ç. te Krahines s'onë

Ne çdo vend te Krahines s'one, ne çdo vend pune, asht prite em gezim te madh, nga te githe, lajmi i ngritjes se Permendores se deshmoreve te L. N. Ç. ne Prishtine. Dita me dite po i dergohen Komisjonit Krahinuer ndihma ne te holla prej keshillave te qyteteve, te rretheve, te vendeve dhe prej personelit te zyrave te pushtetit e t'entеve tjera.

Qe ketu po i veime ne dukje ndihmat e mbrrijtuna tash se fundi:

Keshilli i Frontit te Rrethit te Ferizait din.	64001
Personeli i Spitalit te Prizrenit „	16962
Keshilli i Frontit te Rrethit Gjurakovc „	34370
Keshilli i Frontit te vendit te Stupes „	4879
Keshilli i Front. te Qytetit te Prizrenit „	4703
Keshilli i Front. te Qytetit te Mitrovices „	1000
Keshilli i Front. te vendit te Kushevcit „	3368
Personeli i Drejtoratit Arsimuer Krah. „	2720
Personeli i Drejtoratit t'Industris se Krah. „	655

Grate shqiptare te Krahines s'one kerkojne ligje kunder mbulimit te femnavet te reja

Kshillit populluer Krahinuer per Kosmet vazhdojne t'i vijnë telegrame prej vendeve te ndryshme te Kosmetit. Me keto telegrame gratë e rinija shqiptare kerkojne prej pushtetit populluer ligje kundra mbulimit te femnave te reja.

Grate e Mitrovices, ne telegramin qe dergojne nga konferenca e tyne thonë keshtu:

„Na 450 gra te mbledhuna ne konferencen t'one, tue u udhëheqe nga d e s h i r a e shumices se grave si dhe nga k e r k e s a t qe u-bane gjate diskutimit, e tue ditë se çarshafi asht pengesa ma e madhe e ngritjes kulturo—arsimore dhe politiko—shoqnore te grave shqiptare, kerkojme prej Kshillit populluer Krahinuer t'aprovoje vendimin, me te cilin te ndalohet mbulimi i femnave te reja shqiptare. Keshtu do te ndalohet perhaja e mateishme e zakonit te mbajtjes se çarshafit, kesaj mbeturine t'erret te pozites robe te grave shqiptare ne te kalueme.

Kerkesa te ketilla kane ardhe dhe vijnë nga te gjitha rrethet e krahines s'onë.

Organizatat e Frontit duhet t'i gjejne format ma te mira organizative te punes

PRISHTINE:

Gjate ketij viti, para te gjitha organizatave te Frontit popullor te Krahines s'one parashtrohen detyre te mdhaja. Kryemja e ketyne detyreve ka nji randesi mjaft te madhe, sidomos, per ngritjen ekonomike dhe kulturore te popullit t'one. Per plotsimin e ketyne asht e nevojshme qe te marrin pjese aktive te gjithe frontistat nder akcjone te ndryshme te punes dhe te gjejne forma ma te mira dhe ma organizative per te. Per reslizimin sa ma ne perpikni, me kohe dhe plotsisht, asht e nevojshme qe t'i kushtohet kujdesi ma i madh marrjes pjese s'antarve te Frontit ne pune dhe te çfrytzohet mire e drejte fuqija puntore, te mbahet evidence e vazhdueshme dhe e perpiket mbi punen qe kryejne organizatat e Frontit.

Perveç kesaj asht e nevojshme qe, qysh tash, me iu perveshe formimit te njisive puntore, ashtu siç asht shtrue ne Kongresin e II te Frontit popullor te Serbis. Neper te gjitha qytetet, rrethet, rejonet e katundet e Krahines s'one duhet me i formue brigadat, çetat e dhetshet. Ne terenin e nji keshillit te vendit duhet me formue brigaden, e ne rast se keshilli i vendit ka teritor te gjane, atehere duhet te formohen dy ase ma shum keso brigada. Ne shtabin e çdo brigade duhet te zgjidhen: komandanti zavendes komandanti, evidentisti dhe disa antare te shtabit. Çeta mund te formohet ne teritorin e nji katundi, ase ne nji organizate themelore te Frontit. Çdo çete duhet t'a kete komandantin, zavendesin dhe pergjegjesin e evidences. Dhetshja formohet per nji lagje, per nji grup shtepijash ase per nji rruge, e ajo duhet te kete skuader komandantin dhe evidentistin.

Pergjegjesat e evidences nder çeta dhe dhetshe e kane per detyre te mbajne evidence te vazhdueshme dhe te perpiket e t'ua percjellin referatet rregullisht njisive te tyne ma te nalta. Shtabi i brigades mbrenda çdo jave duhet te paraqes nji referat mbi punen e brigades pran asaj organizate te Frontit, ne terrenin e se ciles gjindet.

Organizatat e Frontit te rrethit ose te qytetit duhet te sigurojne referate 15 ditshe prej te gjitha organizatave te terenit te tyne. Keto kane per detyre qe t'i dergojne Keshillit Krahinuer te Frontit Popullor ne Prishtine pasqyrat e pergjithshme mbi punen e organizatave te tyne. Referatet duhet te mbrrijne ne Keshillin Krahinuer te Frontit Popullor prej nji deri me 5 te çdo mueji.

Kushti ma i domosdoshem per mbarvajtjen e punes s'organizatave te Frontit asht perpiknija. Kjo do te vleje qe ne t'a dis'him m'u te çmohet mire dhe me saktesi puna e sejciles organizate te Frontit ne Krahinen t'one.

Nga mbledhja e parë e Këshillit te ri ekzekutiv te Frontit popullor Krahinuer

PRISHTINE:

Ne Prishtine u-mbajt mbledhja e pare e Keshillit te ri Ekzekutiv te Frontit Popullor te Kosoves e Metohis. Ne ket mbledhje u-ofrmue keshilli per kremtimin e 1 Majit ne Kosmet. Ky keshill do te hartoje planin dhe programin e kremtimit dhe do t'i kryje te gjitha punet fillestare, ne menyre qe festimi te jete sa ma i organizuem. Ne ket keshill bajne pjese 20 antar — perfaqsues t'enteve dhe t'organizatave masovike te Krahines.

Njikohsisht u-formue dhe komisjoni krahinuer i garave per caktimin e rezultateve te 1 Majit.

Mandej u-formue keshilli inisjativ per formimin e Bashkimit te shoqnive kulturo-arsimore te Kosmetit. Ne ket keshill u-zhgjodhen 19 perfaqsues te shoqnive dhe enteve kulturo-arsimore te Krahines s'one. U-vendos qe asambleja inisjative e bashkimit te shoqnive kulturo-arsimore te Kosmetit te bahet ne Prishtine me 25 te ketij mueji. Ne ket mbledhje do te marrin pjese afer 200 delegat nga vendet e ndryshme te Krahines s'one.

U-muer vendimi qe te gjitha organizatat e Frontit popullor ne Kosmet t'i ndihmojne keshilat e rretheve per gjetjen dhe perfshimjen n'ekonomi te kuadrave te reja, t'i ndihmojne ne punen e tyne per sigurimin e sipermarrjeve ekonomike te Krahines me fuqin e nevojshme puntore dhe te mbahen konferenca me puntor qe paraqiten per pune ne sipermarrje.

Ne fund keshilli ekzekutiv i Frontit popullor Krahinuer te Kosmetit vendosi qe me 9 Maj te kryhen zgjidhjet per keshillat e Frontit Popullor per te gjitha organizatat themelore n'ato vende ku deri tash nuk kane egzistue.

Formimi i seksjoneve pranë Këshillit Krahinuer te Bashkimit te Luftëtarëve te Luftes N. Çl.

PRISHTINE:

Keshilli Krahinuer i Bashkimit te luftetarve te luftes Nacional—Çlirimtare per Kosove e Metohi, para dy ditesh mbajti mbledhjen e tij. U-formuen kater seksjone: seksjoni per stervitjen paraushtarake, seksjoni per mbledhjen e dokumentave dhe materjalit nga lufta Nacional—Çlirimtare, seksjoni per kujdesin ndaj luftetarve, invalidve dhe familjeve te luftetarve te luftes N. Çl. si dhe ai per punen kulturo-arsimore.

Mbas shqyrtimit te detyreve qe shtrohen para seksjoneve, u-vendos qe te gjitha seksjonet t'ia fillojne punes me nji here.

Ne mbledhje u-formue dhe keshilli inisjativ i Bashkimit te shejtarve te Jugosllavis per Kosove e Metohi, i cili duhet te pregatite e t'organizoje asamblen krijonjese ne Prishtine.

Keshillat inisjative te Bashkimit te shejtarve po formohen po per ket qellim neper te gjitha rrethet e qytetet e Krahines s'one.

PRISHTINE:

Frontistat e rrethit te Prishtines tue i realizue detyrimet e marruna persiper, ne punet e ndryshme, kane dhane mbrenda muejve Fruer e Mars te ketij viti 5857 dite pune vullnetare. E gjithe kjo pune asht dhane per nxjerrjen dhe bajtjen e gureve, te ranes per shtepijat kooperative, per hapjen e kanaleve te ndryshem, lavrimin e thelle per mbjelljen prandverore etj. Vlefta e kesaj pune llogaritet ne 600.000 din. Rezultatin ma te mire e kane dhane frontistat e keshillit te vendit Komorane, te cilet per 2877 dite pune vullnetare kane kursye afer treqind mij dinare.

Nga veprimtarija e F.A.G.-es se rrethit te Prishtines

Të djelen, me 11 pril u-mbajt konferenca e rregullt vjetore e grave të rrethit të Prishtinës. Në referatin e punes u parashtruen rezultatet e marruna gjatë vitit. U-shqyrtuen të metat dhe lëshimet gjat vitit dhe u-parashtruen detyrat e ardhëshme.

Prej fillimit të vitit të kaluem e deri tash organizata asht forcue mjaft në pikëpamje organizative udhëheqësinat janë zgjedhë nga pikëpamja kombetare 80% ma mirë. Nepër katundet shqiptare janë formue këshillat dhe gratë punojnë aktivisht. 1359 gra shqiptare e serbe kanë mësue shkrim e këndim, gja që asht sukses i madh në lamën kulturo-arsimore. Janë mbajtë 12 tema në lidhje me higjijenën e shëndetin. Punojnë rregullisht 325 grupe leximi. Gjat të tanë vitit gratë e rrethit të Prishtines kanë dhanë 45.192 orë pune vullnetare në ndertimin e objekteve të ndryshme ndertimore dhe n'akcionet që ka organizue Fronti populluer. Gratë e këtij rrethi kanë mledhë ndihma të ndryshme n'ushqim e veshë-mathje me nji vlerë pjrej 15.520 dinarësh për shtepijat e fëmijve, internatet e kuzhinat e nxanësve, janë dergue në hekurudhen Shamac-Sarajevë disa paketa të ndryshme me nji vlerë prej 9994 dinarësh.

Ndër të metat kryesore të tyne ka qenë puna e dobët me shqiptaret. Ende gjindet nji numër i madh grash jashta organizatës.

Gratë nuk kanë luftue sa duhet kundra elementave anmiqë në rradhët e tyne.

Nder detyrët ma të randësishme që shtrohen para tyne asht pjesëmarrja në ndertimin e shtepijave kooperative, në forcimin e kooperativizmit, masovizimin e organizatës, sidomos, tue i përfshi shqiptaret që gjinden jashta saje, lufta për paqë, etj.

Në fund u-zgjodh këshilli ekzekutiv dhe plenumi i rrethit, u-zgjodhën delegatet për konferencën Krahinore dhe për kongresin e dytë të grave të Serbis.

MITROVICE:

N'organizaten e FAG-es, ne rrethin e Zveçanit jane antarsue ma se 8000 gra. Gjate vitit te kaluem ato kane marre pjese nder akcjone te ndryshme si ne pyllzimin, mbajtjen e pastertis nder punet bujqesore. Ne keto akcjone antaret e FAG-es te rrethit te Zveçanit kane dhane afer 11.000 ore pune vullnetare, me gjithe qe tue marre parasysh masoviletin e kesaj organizate, asht e pamjaftueshme. Me gjithse n'organizate jane antarsue mjaft shqiptare, prej 1559 grave te cilat kane mesue shkrim e kendim ne vitin e kaluem, nuk ka asnji prej tyne. Ne grupet lexuese gjithashtu nuk ka pase shqiptare. Keto gabime dhe mungesa rrjedhin nga se keshilli i rrethit te FAG-es nuk i ka ndihmue keshillat e vendeve te FAG-es aq sa duhet.

Mirepo, tash ka fillue te permirsohet puna organizative e organizates se grues kudo ne teritorin e ketij rrethi. Ne lidhje me vendimet e Kongresit te II-te te grave te Jugosllavis jane ba zgjedhjet e keshillave te vendeve dhe jane zgjedhe udheheqesinat e FAG-es. Me rastin e zgjedhjeve te ketij viti per organet e Frontit populluer e kane hjeke çarshafin 21 gra shqiptare. Ne kurset analfabetike jane perfshi 700 shqiptare. Ma se 100 antare jane pajtue ne revisten „Zora".

Ne konferencen e mbajtun para pak ditesh asht ndermarre qe te gjitha organizatat e vendeve te grave ne rrethin e Zveçanit t'i perpunojne dhe t'i konkretizojne planet e veta te punes. Per ket do t'iu vijn ne ndihme atyne keshilli i rrethit te FAG-es dhe keshilli i rrethit te Frontit, ku do te perpiqen qe n'organizaten e grues te perfshihen te gjitha grate e ndershme e perparimtare shqiptare.

Ekonominat bujqesore te shtetit luejn rrol te randesishëm per perparimin e bujqesis s'one

Ne krahinen t'one jane formue dhe po formohen institute dhe ekonomina bujqesore te shtetit. Keto kane per qellim kryesuer-perparimin e bujqesis me ane te seleksjonimit dhe rritjes se farnave ma te mira te drithnave, perimeve, pemve e kulturave tjera bujqesore. Keto duhet te jene shembull per bujqit t'one ne menyren e rritjes se kulturave bujqesore dhe me i tregue praktikisht dhe menyrat me ane te cilave arrihet prodhimi sa ma i madh. Ne keto ekonomina do te zbatohen metodat ma moderne te punes, masat agroteknike do te zgjidhen llojet ma te mira te farnave, do t'u jepen katundarve udhezime etj. Te gjitha keto do te kontribuojne per ngritjen e bujqesis qe nder ne ne Kosmet asht e prapambetun jo per shkak te kualitetit te keq te tokes ose te klimes, por vetem per shkak te perpunimit primitiv.

Tash ne fillim te mbjelljeve prandverore ka randesi te madhe qe ekonominat bujqesore te shtetit te punohen me nji here. Sa ma pare e sa ma mire te punohen keto pasunina aq ma pare mund te pritet se bujqesija jone do te fitoje farna ma te mira, fidane ma te mira pemesh e rrushi, lloje ma te mira bagetije, aq ma shpejte mund te pritet qe katundari yne do te mesoje si duhet me i rrite bletet e shpendijte, qe katundari i jone te bahet bujke i kulturuem.

Mirepo, asht diktue se disa pasunina mbesin mbrapa, sepse nuk kane fuqi te mjaftueshme puntore per punimin e tokes. Organizatat t'ona masovike shpesh here deri tash u kane dhane ndihma ekonomive bujqesore te shtetit. Kjo ndihme ka qene shum e çmueshme sepse me te asht zgjidhe suksesi i punve te mbjelljeve ose korrjeve. Ne t'arthme, per shkak te numrit te shtuem te punimeve bujqesore te shtetit, do te nevojitet ndihma edhe ma e madhe e organizatave masovike. Prandaj do t'ishte mire qe organizatat e Frontit, e sidomos keshillat e Frontit ne rrethe, te merren vesht me drejtorinat e ekonominave bujqesore te shtetit per perpiljimin e planit per t'ia shpjegue popullit randesin e punes ne keto ekonomina dhe t'a nxisin popullin masovikisht ne kete akcjon per punimin e ketyne pasunive. Duhet me parapa pikerisht se kur dhe sa njerez do te marrin pjese ne pune, e pregatitjet duhet me i krye me kohe, keshtu qe njerzit qe punojne ne keto pasunina te mesojne sa ma teper. Nuk duhet humbe nga syt se te gjithe ata qe marrin pjese ne ngritjen e ketyne pasunive njikohesisht naltesojne edhe vetvehten e tyne. Keta duhet te mesojne se si rriten kulturat e ndryshme, si ruhen prej damprueseve, si mbahen bagtija, shpendijt, bletet etj. Per ket gja duhet te kujdesen udheheqesat e pasunive bujqesore te shtetit, te cilet duhet t'i pregatisin themat dhe udhezimet e vlefshme nga lami i bujqesis. Mandej popullin duhet me e njofte dhe me e mesue praktikisht me metodat e reja te punes.

Ne Gjakovë do te ndertohet nji thertore e re moderne

GJAKOVE

Ne kuadrin e planit te ndertimeve, frontistat e Gjakoves, n'vend te thertores se vjeter primitive, do te ndertojne thertoren e re moderne. Punet fillestare kane fillue: deri tash jane sjelle ne vend te ndertimit 70 kubike zalle dhe sasina tjera materijali ndertimuer. Punet pregatitore marrin fund me 15 prill te ketij vitit, kur do te filloje ndertimi i thertores.

Veç kesaj asht parapa zgjanimi i shtepis se kultures, e cila nuk asht ne gjendje me i plotsue nevojat e vendit. Parashifet te ndertohen dy salla moderne: njena per çfaqje e defrime e tjetra per fiskulture.

Ket akcjon te frontistave te qytetit te Gjakoves e ndihmojne edhe frontistat e keshillave te vendeve te ndryshme te rrethit si p. sh. Smaçi, Rogova dhe Drenoveci.

Deri tash jane grumbullue ne vendin e ndertimit 300 kubike zalle, 20 kubike drrasa te nxjerruna ne bjeshket e Lloçanit dhe 100 kubike gure.

Ne keto ak'cjone dallohen si ma te miret frontistat e rejonit te pare.

Me keto ndermarrje te tyne frontistat e Gjakoves tregojne vetedije te nalte se çdo gja qe ndertohet — ndertoehet per te miren e tyne, per ngritjen e standardit te tyne jetesuer, prandaj dhe i perveshe punes me aq hov. (T. H.)

Brigada e pare e Kosmetit ne ndertimin e autostrades „Vllaznimi e bashkimi"

Ne fushat e mdhaja te Sremit brigadat e Rinis popullore te Jugosllavis ia filluen vepres se re te madhe. Katerdhete brigada te rinis me ma se 10.000 ndertuesa do ndertojne autostraden e pare „Vllaznimi e Bashkimi". Prap po valojne flamujt e hekurudhave Brçko—Banoviçi e Shamac—Sarajeve.

Qysh ne ditet e para brigadat puntore n'autostrade zhvilluen gara. Ne sekcjonin e pare punojne njena prane tjetres brigada e Zagrebit, e Maqedonis, e Zares, Sarajeves e Beogradit. Afer tyne asht brigada e pare e Kosmetit e perbame kryesisht prej shqiptarve. Kapuçat e tyne te bardhe thithen pikat e djerses se pare. Qysh ne dy ditet e para korren suksese te shkelqyeshme: mbrenda kohes rekorde e kane grye te tane siperfaqen e vendpunimit te tyne. Nderuesi Osman Faiku, nga rrethi i Llapit, nuk dshiron me u-kthye pa shejin e sulmuesit.

—Edhe kete detyre do ta kryejme para afatit te caktuem-thot Osmani. Keto fjale jane edhe fjale te te gjithe ndertuesave tjere.

Tregtija me çmimet e lidhuna

Katundaret e Krahines s'one tue i shite prodhimet e veta bujqesore blejne sasina te mdhaja artikujsh te ndryshem industriale

Fushe Kosove

Ne kooperativen shite-blemse te Fushe Kosoves asht tue u-zhvillue me plan tregtija me çmimet e lidhuna dhe per dite mberrihen perfundime te mira. Para dyqanit dhe magazinave te ndryshme te kesaj kooperative vlon zhurma e katundarve, te cilet, nga nji ane shesin prodhime te ndryshme bujqesore e n'anen tjeter blejne sasina te mdhaja artikujsh industrijale me çmime t'unjisueme ma t'ulta. Kjo kooperative ka ble deri tash ater 3 vagona e gjysem drithna, 1500 kg. mish, ma se 2200 kg. fare konopi, 2500 kokrra voe etj. Prej dates 7 e deri ne mramjen e dates 9 te ketij mueji jane ble 3280 kg. miser, 1011 kokrra voe, 1390 kg. tershane, 190 kg. fare konopi, 250 kg. elb, 5 kg. mish pule, 5 kg. yndyre etj. N'anen tjeter katundaret blejne, me kundravleften e prodhimeve te shituna, artikuj te ndryshem industrijale, keshtu qe gjiroja e dites mbrrini ne shum mija dinare.

—Ndihet nevoje e ngutshime, thote magazinjeri i kooperatives, per bez, basma, vegla te ndryshme bujqesore, stofna, xhama, lande nderimi etj. Mirepo, shpresojme se per se shpejti do te na mbrrije i gjithe malli i porositun dhe keshtu do te mundem me i plotsue te gjitha nevojat e katundarve t'one qe shesin e blejne me çmimet e lidhuna.

Strelle i Eperm

Kooperativa shit-blemse e Strellcit ka filllue vone tregtin me çmimet e lidhuna, por qysh ne ditet e para ka mbrrijte suksese te mira. Ka ndodhe qe mbrenda nji dite jane ble artikuj bujqesor dhe shite artikuj industrijal me vleften deri ne [illegible] 900 [illegible].

Perveç tjerash, kjo kooperative, ka ble deri tash gjashtemdhetë [illegible] kgr. grosh dhe njimije kgr. misa, blemjen e pulave, voeve dhe te leshit nuk e ka fillue ende, per shkak se bashkimi kooperativ i rrethit nuk i ka dergue udhezimet e duhuna, kurse katundaret presin qe t'ia shesin kooperatives dhe keta artikuj e te blejne çka u nevojitet.

Kooperativa asht e zbukurueme me parolla te ndryshme, te cilat u a skjarojne katundareve edhe ma teper se sa mundet me ble me artikujt e tyne bujqesore. „Per njiqind kgr. grune ka mujte me ble katundari 21,7 litra gaz, e tash me çmimet e lidhuna mundet me ble 74,9 litra" - asht porosia qe bje ne sy ma se shumti. Per ane ne kooperative mberrijne mallna te ndryshme industrijale mirepo nuk ka mberijt ende i tane malli i porositun, keshtu qe tregtija me çmime te lidhuna nuk ka mujte me e marre ende hovin e duhun.

—Edhe dega e jone n'Isniq, thote magazinjeri Ahun Bajrami, ka ba nji shitje te madhe dhe katundaret kane ble nga disa metra tekstil dhe disa vegla bujqesore.—

—Disa thone se çmimet e artikujve t'one jane t'ulta, shton Mus Shabani, sepse disa njerez kane qene mesue gjate luftes qe per hiç gja te marrin shumna te mdhash pa kurrfare vlefte. Une e kam llogaritë se per 500 kgr. do te mundem me ble shum ma teper malle se sa kam mujt me ble para lufte e se sa do te mujshe me ble me shit-blemjen ne treg te lire. Na e kemi kuptue se sistemi i tregtise me çmime te lidhuna asht ne dobin t'one-ne dobin e njerez se puntore te katundit e te qytetit prandaj te gjithe i jemi pervesue punes me mish dhe me shpirt ne menyre qe te mundemi me nxjerre sa ma shum prodhime e te mundemi me i plotsue te gjitha nevojat t'ona.

Ky asht mundimi i te gjithe katundarve te ketij vendi. Katundari Çut Sadiku, ka sjelle para disa ditesh ne kooperative 200 kgr. pasul dhe me kundervleften e tij ka ble: bez enet te ndryshme, rrathe per rrota qerresh. Ay thote se me kete sasi pasuli nuk do te mundete nga i ble kurre gjith'ato sende para lufte e as sot ne tregun e lire.

Katundaret ma se shumti interesohen per bez te dyfishte, per gas, per rrathe e osa qerresh, tfurq plehu, lande nderimi, kepuce, opinga gome etj. Kryetari i kooperatives i siguron katundaret se per se shpejti do te mberrijne te gjithe artikat e nevojshem dhe kooperativa do te mundet me u a plotsue katundarve te gjitha nevojat e tyne.

—Te rrallë jane ata njerëz qe nuk i shesin tepricat e prodhimeve te veta me çmimet e lidhuna

— Thonë katundarët e rrethit te Suharekës

Katundaret e pare, ne rrethin e Suharekes, qe iu kane shite kooperativave prodhimet e veta me çmimet e lidhuna jane: Hamit Tahiri, Sejdi Ademi, Hamdi Smajli, Rexh Misini. Keta kane shite ne kooperativa bagti, drith etj. Rexh Misini, plak ma se 60 vjeç, nga katundi Vraniq, i pari i ka shite me çmime te lidhuna disa krene dhensh.

— Nuk dij, thote Hamid Tahiri, sepse katundaret t'one u-rrodheshin ne fillim. Une nuk bana si ata. E para, per shkak se kam besim te plote ne pushtetin t'one popullor, qe ka mendue, mendon e do te mendoje gjithmone vetem per te miren e puntorve e te katundarve dhe e dyta, per shkak se, more vlla, me gjithse jam njeri pa-shkolle kam mujte me llogarite se kam shume ma teper dobi prej çmimeve te lidhuna, shka e vertetoj perseri se çdo mase qe merr shoku Tito ka per te vetmin qellim me na sigurue jeten ma te mire te njerzve te punes. Une me nji here kam shite dhe do te shese me çmimet „t'ona", d. m. th. me çmime te lidhuna. Keshtu punojne tash edhe bashkekatundaret e tjere. Edhe ata e kane kuptue e bile mire se ku qendron puna.

Kur e pyeta se a ka njerez ne katundin e tij qe nuk i shesin tepricat e prodhimeve te tyne me çmimet e lidhuna, ay me pergjigjet ne buzqeshje: a thue nuk do t'ishte ma mire sikurse te me pyetshe nese ka katundare qe shesin me ndonji menyre tjeter e jo me çmimet e lidhuna —ata jane pak sa qe njeriu mund t'i numeroj me gishta.

Deri me 8 te k. m. ne rrethin e Suahrekes jane shite me çmimet e lidhuna 9543 metra tekstil, 2000 kgr. sheqer, 2400 artikuj hekurishtash, 10 cope biçikletash etj. Deri me kete date katundaret kane shite neper kooperativa 10893 kgr. miser, 511 kgr. drithna, 132 kgr. theken, 417 kgr. pasule, 10178 kgr. mish dhe nji sasi te madhe pulash e voesh.

Deri tash ne rrethin e Suharekes ka mbrrijte malle industrijal me nji vlefte rreth nji miljon dinaresh, shumica e te cilit asht tekstil, voj-guri, xham, rrathe qerresh, gozhda etj. Para magazines se rrethit shum katundare i shikojne me interesim te gjalle artikujt e ri gjithnji ma te mire qe iu kane sigurue vllaznit e tyne-puntoret, qe punojne me qindrushmeni ne sipermarrjet t'ona industrijale per te permirsue jeten e katundaris s'one punonjese. N'anen tjeter katundarija e jone punon pa pra per t'ju sigurue sa ma mire puntorve buken dhe gjanat tjera ushqimore. Me anen e çmimeve te lidhuna vllaznimi ne mes te puntorve dhe katundarve fiton bazen materjale bazen ekonomike.

Nder katundet e rrethit te Suharekes jane dallue deri tash ne tregtin me çmimet e lidhuna Sopina dhe Mamusha. Sopina shet ma se shumti drith e Mamusha bageti.

Shtresave te vobegta te katundaris, qe nuk kane teprica prodhimesh, iu ka dhane pushteti popullor libreza per furnizimin e siguruem. Por keto do te jetojshin edhe ma mire sikurse te shkojne me punue ne minjerat ose sipermarrjet t'ona industrijale.

Prej atyne qe punojne ne kooperativa, asht angazhue ma se shumti ne tregtine me çmimet e lidhuna Bajram Arifi, magazinjer, i kooperatives se Sopines.

—Me jepni mall industrijal, thote Bajrami, e per artikuj bujqesor, mos mbani kasavet. Katundaret t'one po i shofin te mirat qe rrjedhin nga tregtija me çmimet e lidhuna. Duhet me u—kujdesue per sa iu perket porosinave ne menyre qe te porositet gjithmone malli qe u nevojitet ma se shumti katundarve t'one.

PODUJEVE:

S'ka mbete katund as [illegible] gje ne teritorin e rrethit te Podujeves, ku nuk jane mbajte ligjrata ne lidhje me tregtin simbas çmimeve te lidhuna. Jane mbajte ma teper se 100 keso ligjratash. Katundarve u asht spjegue mire randesija e dekret-ligjeve mbi menyren e re te furnizimit me mallna industrijale. Tue e pase kuptue mire randesin dhe dobin e shkembimit te prodhimeve me mallna industrijale me çmime te lidhuna, prodhuesat e ketij rrethi kane shkembye me mallna deri me kater te ketij mueji 66472 kgr. drithna, 24733 kgr. bagti te trasha dhe t'imta, ater 1000 kgr. patate dhe ma se 11.000 kgr. pasul.

Vetem magazina shtetnore e Podujeves ka ble me çmime te lidhuna ma teper se 11.000 kgr. bagti te trasha e t'imta.

Ne diten e pazarit te javes se kalueme, ne Podujeve, nuk ka pase shitje prodhimesh ne treg te lire, sepse bujqit kane shite te gjitha prodhimet e veta me çmime te lidhuna.

VUÇITERNE

Ne rrethin e Vuçiternes, ne kohen e fundit, jane mbrrijte rezultate te dukshme ne shitjen e prodhimeve bujqesore me çmime te lidhuna. Dita dites po forcohen kooperativat shit-blerse dhe po korren sukses ne shkembimin e mallnave me prodhimet bujqesore, gja e cila po u a plotson ma se miri nevojat e katundarve.

Deri me kater te ketij mueji te gjitha kooperativat ne teritorin e rrethit te Vuçiternes kane ble 109.000 kgr. drith, 2.800 kgr. pasul, 8350 kgr. kafshe te trasha dhe t'imta; 4500 kgr. te fares se konopit dhe 800 kgr. te fares se linit. Blemja e prodhimeve bujqesore me çmime te lidhuna ka kushte me u-zhvillue edhe ma mire sikur, malli i porositun industrijal te mbrrije me kohe dhe ne sasina te mjaftueshme.

Puna e mbjelljeve prandverore asht detyre per te gjithe, prandaj duhet me ba ç'mos qe plani te realizohet n'afatet e caktueme

Puna per realizimin e planit te mbjelljeve prandverore ka fillue te marre hovin e duhun. Shiu i diteve te fundit e ka ba te mundshem zbatimin e perpiket te planit te mbjelljeve dhe e ka zhduke veshtersine e madhe qe paraqitej deri tash.

Mbjellja e grunit prandveror asht krye dhe plani i parapame asht tejkalumi. Plani i mbjelljes s'elbit ne mbare Krahinen t'one asht realizue me 70%, e ne rrethin e Gilanit asht tejkalue. Plani i mbjelljes se tershanes nuk asht realizue ende per shkak te vonese se fares, porse ne vendet malore mund te vazhdoje edhe ma mbjellja e kesaj bime. Persa i perket mbjelljes se tershanes rezultate ma te mira jane mberrijte ne rrethin e Prishtines. Plani i mbjelljes se lule-diellit asht realizue me 15% e ai i theknes me 60%. Plani i mbjelljes se patateve nuk asht realizue e afati i mbjelljes asht afrue mjaft, prandaj duhet me ba ç'mos qe mbjelja te mbarohet ne kohen e. Me perjashtim te rrethit te Gilanit e te Liplanit, gadi n'asnji vend te Krahines s'one nuk asht tue u-zhvillue me plan puna per mbjelljen e bimeve per ushqimin e bagetis. Ne rrethin e Gjakoves Pejes dhe t'Istokut nuk asht tue u-zhvillue si duhet puna per mbjelljen e terfonjes, ku plani asht realizue vetem me 5%. Tue qene se bimet per ushqimin e [illegible] ag [illegible] luejne rrol te randesishem ne mbajtjen, ushqimin dhe shtimin e numrit te bagetis, mbjelljes se ketyne bimeve duhet me i kushtue kujdes te veçant. Organet e pushtetit dhe organizatat popullore nuk jane angazhue aq sa duhet n'organizimin e punes per mbjelljen e atyne kulturave dhe nuk e ka ne skjarue popullin sa duhej mbi dobitë e mbedhaja te ketyne bimeve.

Katundaret e dijne se sa ma heret qe te kryhen mbjelljet, aq ma shum do te merren prodhime mbasi bima e mbjellun here mundet me u forcue shpejt, me i perballue thatesinat dhe me i rrite normalisht, prandaj afatet e caktueme per mbjelljen e çdo kulture duhet te respektohen.

Me mija katundar te Krahines s'one kane marre persiper me [illegible] shtue prodhimin per ç'do hektar si per kah cilsija ashtu edhe per kah sasija, tue u shpejtesue ne kete menyre realizimi i Planit pesvjeçar. Organizatat e Frontit popullor kane parapa ne planet e veta shtimin e prodhimit te te gjitha kulturave prej 7—15% per çdo hektar ne krahasim me vjetin e kaluem. Disa katundarve, qe kane marre persiper me i zbatue masat agro-teknike, iu mungon ndihma eksperte dhe mjetet [illegible] nevojshme, prandaj asht mire me ba mbledhje me ta, me iu dhane udhezime dhe me u kujdesue qe te pajisen me mjetet e duhuna dhe me pleh artificjal. Ky problem do te zgjidhet ma se miri me anen e kooperativave, te cilat me ndihmen e organizatave te Frontit, duhet te perpiqen me i gjete veglat dhe maqinat e nevojshme. Me e ngrite çdo katundar ne lufte per sa ma shum prodhime don me thane: me kontribue ne realizimin e Planit pesvjeçar, ne perparimin e bujqesis s'one, ne permirsimin e pergjithshem te gjendjes ekonomike te katundaris, ne ngritjen e nivelit jetesuer te furmave t'ona punonjese ne katund e ne qytet. Lufta per shtimin e prodhimit bahet tash me rastin e realizimit te Planit te mbjelljeve. Sa ma teper qe t'iu permbahen katundaret udhezimeve t'ekspertave bujqesore e t'organeve te pushtetit, aq ma teper do te munden me i shtue prodhimet e veta. Organizatat popullore duhet t'angazhohen edhe ma teper qe lufta per shtimin e prodhimit te perfshije ç'do katundar te Krahines s'one.

Te metat e deritashme kane rrjedhe nga mos organizimi i mire i punes se mbjelljeve. Nder organizatat e frontit nuk shifet nji pune e perditshme per sa i perket bujqesis, e ne disa katunde nuk ekzistojne seksionet bujqesore. Aktivet bujqesore duhet te perbahen nga katundaret ma perparimtar, qe dijne me e studjue gjendjen e katundit te vet. Keta duhet t'a organizojne punen ashtu si duhet, e te perpiqen per zbatimin e udhezimeve t'ekspertave bujqesor. Ne disa aktiva bujqesore ndodhen njerez qe fare pak marrin vesht nga bujqesija dhe nuk perpiqen qe aktivet e tyne te perforcohen dhe te jene ne gjendje me e perballue çdo pune.

Zbatimi i Planit asht i lidhun ngushte edhe me kontrollin e evidencen e mire. Prandaj keto dy kushte duhet t'organizohen ma se miri. Organet e pushtetit dhe organizatat popullore duhet te bajne lufte te pa-preme per organizimin e punes me plan dhe te japin ndihmen e tyne te vazhdueshme gjate gjithe kohes se mbjelljeve, tue u-perpjeke me i plotsue te gjitha nevojat dhe tue dhane udhezime praktike ne terren. Kjo mund te mbrrihet vetem tue qene ne gjithnji ne lidhje me zhvillimin e punes se mbjelljeve. Puna e mbjelljeve asht detyre per te gjithe, prandaj duhet t'i pervishemi punes edhe ma me hov ne menyre qe mos te mbetet pa u-mbjelle asnji pllambe toke dhe plani i mbjelljeve te realizohet perpikenisht, sepse vetem keshtu mund te mbrrihen suksesat e deshiruemë.

Lajme te shkurta nga Krahina e jone

PODUJEVE:

Ne kete rreth asht plotsue krejtesisht plani i tregtis me çmime te lidhuna per muejin prill.

N'organizimin e tregtis me çmimet e lidhuna dallohen si ma te mirët Rahman Bajrami, e Bogdan Cimbulevig. Qe te dy, punojne pa pra prej ores 6 deri ne oren 22, dalin ne teren dhe u ndihmojne te gjitha kooperativave te vendeve.

LIPLAN:

Mbjellja e elbit, tershanes, lule diellit, terfojes dhe patateve ka marre fund me 5 prill ne terrenin e keshillit popullor te vendit Gadimlje e Poshtme. Keto kultura, me perjashtim te patateve, jane mbjelle qind per qind simbas planit te parapam. Mbjellja e kulturave te tjera asht tue vazhdue gjithnji. Sektori informativ asht mjaft aktiv.

LIPLAN:

Ne Gadimlen e Poshtme te ketij rrethi po bahen pregatitje per ndertimin e ndertesës se keshillit popullor te vendit dhe ndertesës se kooperatives. Jane ba te gatshme rana dhe guret, asht pregatit nji vagon gelqere e pashueme se shpejti do te prodhohen edhe dy vagona te tjere.

Fronti Popullluer i Gramaçelit ka marre persiper detyrime te mdhaja per vitin 1948

Në mes të Gjakovës e Deçanit gjindet katundi Gramaçel. Aktivistat e Frontit të këtij vendi, Këshilli Krahinuer i Frontit Popullluer i shpalli si ma te miret ne Kosmet.

Çobanet, plot gazmend, kangë e hare, ruejnë kopet e dhenve pas te cilave kecejne e losin shtjerrat. Lavërtaret u grahin qeve e kuajve per t'i krye sa ma pare mbjelljet prandverore—per ta plotësue me kohë planin e mbjelljeve e keshtu te dishmojne me veper per lavdaten dhe meriten qe kane fitue si ma te miret ne Krahinen t'onë.

Aty kah mesdita katundi ushton,—janë pionerët e pioneret që, të rrjeshtuem, tue këndue kangë herë shqiptare herë serbe vijnë prej shkolle me hanger drekë.

Marrëdhanjet ndërmjet popullsis shqiptare e malazeze kanë u zhvillue kryekput.

— Para lufte—thotë Radojko Zogoviq—katundarët e Gramaçelit ishin plot trishtim, vuetje e mjerim. Edhe shqiptarët edhe malazezet e ndijshin vehten te plagosun randë. Reforma agrare e vitit 1937—38 e qëlloi randë shqiptarin. Prandaj shqiptarët urrejshin me shpirtë shtetin dhe njerzit që e drejtojshin atëherë ate regjim.

As jeta e emigranteve nuk ka qenë ma e mirë—thotë Ali Meta.

Sot asht krejt e kundërta. Babat dhe nanat i edukojnë femijt e tyne ne frymen e vllaznimit e të bashkimit te pashgatrrueshëm, ne frymen e dashunis se singerte vllaznore, i edukojnë se si shqiptarët e malazezët janë popull i ngjajshëm, u flasin per doke e zakone të perbashkëta e te barabarta, per interesa, te perbashkëta jetësore. Aq janë te ngushta e vllaznore marredhanjet ndermjet tyne sa qe grate shqiptare nuk u mshifen malazezve.

Mbas vuejtjeve katervjeçare shum te vshtira nepër shpella e kësolla, të launna në mëshirën e mjerimit e brengave, familjet koloniste gjeten strehe te shqiptaret. Ma se 140 familje koloniste, të cilave ua dogi shtëpijat fashizmi, i muerën shqiptarët e Gramaçelit ne shtepijat e tyne.

— Shqiptarët na kanë dhanë ndihmë te madhe—thot Radojko Zogoviq. Kur erdhem këtu nuk kishim kurgja mbas shpirtit—hija e uris dhe vuejtjeve na i kishte mbulue fetyrat t'ona. Na muerën, na dhanë drith dhe bageti, femijve t'one dhe neve na e shpetuen jeten. Ishim bashkë ne nji votër, e nuk mbahet mend asnji fjalë e keqe ndër ne.

— Detyra e jonë e parë ka qenë nderimi i shtëpijave koloniste—thot Ali Balije, katundar i cili ka dhanë kontributin ma të madh në ndertimin e këtyne. Në vitin 1946 ndërtuem 13 shtëpija koloniste, e vitin e kaluem—72. Asht qenë punë e madhe;nevojiteshin 4,000.000 copë qerpiç, afro 3.000 kubikë gurë, duheshin pre, bajtë e latue 800 kubikë landë druni. Këto gjindeshin 40 km. larg—në prijat e pjerrta të Budoshit e Jodovës. Por puna e perbashket dhe me vullnet ban çmos. Pioneri Halil Hamza nxierrte nga 500 copë qerpiç mbrenda dites, e te rijt Mon Hamza e Sali Ahmeti — edhe nga 1500 copë. Me nga 150 pendë qe shkojshim me sjellë materijalin. Këshillëtaret e Frontit e të pushtetit kanë qenë të parët në punë. Qe, p.sh. Radojko Zogoviq, përveç punës që kryente si sekretar i kshillit të vendit, çdo ditë punonte bashk me rini, burra e pionerë. Unë tue perdorë mënyren e re të muratimit, per dy ditë kam zidue nji shtëpi koloniste.

Ne rejonin e këtij kshillit popullluer e tanë toka në vitin e kaluem asht lavrue e mbjellë. Kolonistat nuk kishin kafshë lavre. Shqiptarët ua kanë lavrue kolonistave të tanë token vullnetarisht. Ka fillue mbjellja prandverore simbas planit që e kanë hartue vetë frontistat. As sivjet kurrkujt nuk do t'i mbetet toka e palavrueme dhe e pambjellun—shqiptarët e malazezët do te ndihmojnë njeni tjetrin.

Për ngritjen kulturore të popullit Fronti asht kujdesë shum. Shkollat fillore shqiptare e serbe në Dobrigje, Ereç e Babajlloqit si dhe paragjimnazin në Dobrigje ndjekin 500 fëmij shqiptarë e malazezë. Druni i zjarrit dhe të hollat për mbajtjen e lokaleve shkollore kanë qenë të sigurueme; nxanësve u asht sigurue ushqimi nëpër menzat e tyne e pjesërisht edhe veshëmbathja. Në Dobrigje asht hapë salla e leximit dhe janë mbledhë të hollat për blemjen e libravet edhe për nji sallë të re leximi e cila do të hapet së shpejti.

Të rijt krenohen me sukseset e tyne. Këta kanë dhanë dhe po japin kontribut të madh në rilindjen e katundit.

— Tue marrë si shëmbull mënyren e organizimit të punve në hekurudhen e Rinis Shamac—Sarajevë, neve po i organizojmë punët nëpër katundet t'ona — thotë Radivoje Ivanoviq, nji nga udhëheqsat e rinis. Ta 'i vonë e kemi formue brigaden e frontistave. Kater çetat që përbajnë brigaden numrojnë nga 80 veta. Të gjithë të rijt, nder të cilët janë 190 që kanë marrë pjesë në hekurudhen e rinis dhe në ndertimin e Beogradit të ri, janë shembull disipline e përpjekjesh. Shumica e të rijve të brigades s'onë do të shkojnë në ndertimin e hekurudhes Metohi - Kukës dhe në ndertimin e autostrades Beligrad—Zagreb. I tanë aktivi i Rinis popullore të Dubraves do të shkojë në këto akcjone. 96 të rij do të shkojnë në muejin prill. Brigadjeret tjerë do të punojnë në kryemjen e detyrimeve të parapame me Planin pesvjeçar të Frontit popullluer.

Fronti Popullluer i Gramaçelit ka marrë përsipër detyrime të mdhaja. Mbrenda këtij vjetit në kët katund do të nderiohet shtëpija kooperative, 40 shtëpija për kolonista dhe godina e paragjimnazit. Brigada frontiste deri tash ka nxjerrë dhe sjellë në vendet e ndërtimit 1300 kubikë gurë e ranë. Për shtëpit kooperative frontistat kanë mbledhë 140.000 dinarë dhe 10 dele. Këto ditë nji çetë e frontistave do të dalë në bjeshkët e Deçanit me pregatitë gelqeren për ndertimin e shtëpis kooperative. Gjatë viteve t'ardhëshme nepër çdo katund do të ndertohen shtëpijat kooperative. Do të ndertohen edhe tri stacjone shëndetsore.

Kur u-vendos të formohet kooperativa bujqësore në Gramaçel frontistat shqiptarë e malazezë kanë diskutue gjanë e gjatë mbi të mirat dhe dobitë që ka me sjellë puna dhe jeta e përbashkët.

Do të jetë shum ma mirë e ma lehtë për ne. Tokat do t'i punojmë me traktora. Do t'i punojmë si nji familje dhe së bashku do t'i ndajmë të mirat që kemi me i krijue na vetë. Atëhere kemi me pasë lumtuni të pashembulltë për ne shqiptarët e malazezet e Gramaçelit.

Kështu punojnë e mendojnë katundaret e këshillit ma të mirë të Frontit popullluer të vendit në Kosovë e Metohi. Kështu farkohet vllaznimi i popujve në kët Krahinë të cilët nuk i ndajnë ma livadhet e pasuna, arat pjellore e pemishtet e begatshme, por së shpejti do t'i bashkojnë pazgjidhmenisht për jetë të jetes.

M. Gj.

Nga Bashkimi Sovjetik

Misjoni i pare i hekterve te lavrave te mbjelluna

Ne krahinat Jugore te Bashkimit Sovjetik, prandvera e ketij viti ka fillue ma heret se zakonisht Kolhozet dhe stacjonet e maqinave-traktorave e priten prandveren e hershme krejt te pregatituna. Ne Jug jane mbjelle deri tash ma se 1 miljon hektare laver me kultura prandverore. Shum krahina te republikave t'Azis se Mesme i kane krye planet shtetnore te mbjelljes se drithnave prandverore shum ma shpejt se ne vitin e kaluem. Ato po mbjellin drith edhe ma-pertej planit te parapam.

N'Ukrajne, ne Krime dhe ne Kaukazin e Veriut, krahas me mbjelljen e drithnave prandverore, ket vit u zhvilluen punimet t'e h mbaj jes se drithnave dimnore. Randesija e ketyne per ekonomin e Bashkimit Sovjetik asht shum e madhe. Prodhimi i pergjitheshem i kulturave dimnore zen ma se 65% te sasis se pergjithshme te drithnave. Ne vitin e kaluem kolhozet e kane zgjanue shum siperfaqen per mbjelljen e grunit dhe theknes dimnore. Ne krahasim me te perparshmen, kjo siperfaqe asht shtue ne vitin e kaluem 3,5 miljona hektar.

Keto rezultate i kane nxite kolhozjanet me marre çdo mase per t'arrijte frytin ma te madh nga kulturat dimnore. Eksperjenca e kolhozjanve perparimtar, heroj te punes socjaliste, tregon se nevojitet, per ket qellim, qe ne prendveren e hershme, posa te shkrihet bora, te zbatohet ushqimi i kulturave dimnore me pleh t'imte mineral.

Plehnimi i kulturave dimnore bahet ne perpjestime te gjana me ane t'aeroplanave. Aeroplanat e vegjel te posaçem, te pajisun me vegla per qitjen e plehut, çohen nga aerodromet e vogla te ndreqtuna prane fushave kolhozjane fluturojne ne nji naltesi te vogel permbi grunin ose theknen e dimnit dhe qesin plehin ne token po sa asht shkri bora, kur bimet kane nevoje te posaçme per materje ushqimore e cila thithet lehte.

Pergjithsisht, n'Ukrajne dhe ne Kaukazin e Veriut ku kryesisht prodhohen drithna dimnore-perdorimi e plehut lokal e mineral ne token e mbjellun me kultura dorimi i plehut lokal e mineralve dhe me menyra tjera, kryhet ne nji siperfaqe prej disa miljona hektaresh. Prej çdo hektari te mbjellun me grune e te jashte i cili asht plehnue ne prendveren e hershme, kolhozjanet nxjerrin 3,4 e ma centa fryte te shtueme.

Edhe vllaçitja prandverore e kulturave te lashta bahet ne perpjestime te gjana. Ky veprim, nga ana e tij siguron nji deri ne dy centa fryt te shtuem prej nji hektarit.

Alma Ata

Ne koken e pushtetit sovjetik asht ndertue sistemi irigativ i vaditjes ne shum krahina te Kazahstanit qe perpara ishin shkretina N'ish „Stepen e unte" asht çele „Oaza e Kirovit". Sistemi modern i vaditjes artificjale perdoret ne 1 miljon e 700 mije hektare lavra e kopshte. Uji ua ka çele rrugen kulturave bujqesore qe perpara nuk rriteshin ne keto vende. Kulturat perparimtare te panxharit nxjerrin nga 1000 centi rrepe sheqeri prej nji hektarit. Ne keto siperfaqe te vaditluna sot rritet edhe drunji i kauçukut, orizi, ricinusi, konopi etj. Siperfaqet nen vade shtohen prej vitit e ne vit.

Ne vitin e kaluem fillol mbushja me uje e Lqenit artificjal Iritall. Ne lumin Cu po ndertohet kanali „Georgijevski". Se shpejti do te filloje ndertimi i objektit ma grandioz irrigativ ne Kazahstan — do te ndertohet jaza Kzil-Ordin mbi lumin Sirdarje, i cili do te rregulloje rrjedhjen e lumit. Me ndertimin e ketij jazi do te sigurohet vaditja e edhe 100,000 hektarve toke.

Nji dite ne kolektivin e rrobaqepsave ne Gjakove

Plani pesëvjeçar i Krahines s'onë ka shtrue detyre te medhaja para zejtaris, qe asht pjese e randesishme e industris s'onë; mbrenda pesë vjetve me e zhvillue dhe ngritë prodhimin e zejtaris me 495% ne krahasim me vjetin 1946. Me e sigurue zhvillimin e matejshem te kooperativave zejtare dhe mbrenda pesë vjetve me mbrrijte vleften e pergjithëshme te prodhimit prej 220 miljon dinaresh keshtu qe te plotsohen sa ma mire nevojat e popullit t'onë.

Forma ma e mire per perparimin dhe zhvillimin e zejtaris asht organizimi kooperativ, jane kolektivat punonjese.

* * *

Si ne mbare Krahinen t'one, ashtu dhe ne qytetin e Gjakoves kemi nji varg keso kooperativash dhe kolektivash punonjese. Nji nga keto asht edhe kolektivi i rrobaqepsave, i cili tash per tash ka 22 puntorë, 4 puntore dhe 6 shegerta. Kolektivin e udhëheqë Minush Murtezaj, i cili ka qene inisjatori i pare i formimit te ktij kolektivi.

—E peshe, thotë ky, se kjo ishte rruga ma e mirë e ma e drejte per nji punë ma te madhe e ma te shpejte, si për te miren t'ime ashtu dhe për te miren e pergjithëshme.

Në sallën e gjatë, te ndritshme e te paster shifet rreshti i maqinave, ne te cilat qepin puntoret e puntoret t'ona. Sutresa e salles dridhet nen ritmin e vazhdueshem te maqinavet. Ne ket kolektiv punonjes deri tash kane punue edhe dy femna shqiptare, por tash njena ka shtue ne kura e tjetra asht e smundë.

—Kjo nuk do te thote se s'kemi me pase edhe femna tjera shqiptare, shton Minushi, sigurisht kane me ardhe edhe shum te tjera.

—Me gjithse kolektivi deri tash nuk ka pase ndonji plan per shkak te mungeses se materjalit e perhershem, prap se prap ka korre sukses te mira.

—Keshilli popullluer i rrethit na ka pase dorzue materjal per 500 cope bluza dhe pantolla, tregon Minush Myrtezaj, dhe na kemi marre persiper me i mbarue per gjashte jave, por simbas normes qe e kemi prande kemi me e krye kete punë mbrenda nji mueji. Tash vonekemi qepe 5000 pale breke per 18 dite, e afatin e kemi pase 45 dite. Per keto sukses te gjithe puntoret jane kryenalte dhe jane gezue teper per te cilen kemi marre edhe nji lavdim.

Kolektivit te rrobaqepsave te Gjakoves per dite i shtohen antaret e rij. Ne kohen e fundit kane ardhe bashke me veglat e tyne shoket Tasim Çarkazhiu Muharrem Shala dhe Isuf F. rizi. Ky kolektiv, perveç punes se vet te perditshme ka ba edhe pune vullnetare; per qepjen e 10 fustaneve baleti per shkollen Normale si dhe per qepjen e veshjes komplete te skuadres se topkambes „Vllaznija" te Gjakoves. Te gjithe antaret e kolektivis jetojne ne harmoni dhe gjithmone ndihmojnë njeni tjetrin. Dallohen per kujdesin dhe disiplinen ne pune shoqja Borka „Gligorijeviq dhe shoku Qemal Murtezaj.

Per te mujet me mbrrijte sukses edhe ma te mira, asht e nevojshme qe ne kolektiv te zhvillohen edhe ma teper gara ne menyre qe prodhimi te permirsohet edhe ma, si per kah cilsija ashtu edhe per kah sasija. Tue i plotsue normat dhe tue u perpjekë qe edhe me i tejkalue, sigurisht, ne kete kolektiv do te dalim edhe ma shum sulmuesa e suksesi t do te jene edhe ma te mdhaja.

Fiskultura dhe Sporti

LAJME TE SHKURTA SPORTIVE

PRISHTINE:

Me datën 11 të k. m. në fushën sportive të shoqnis "P r o l e t e r" të P r i s h t i n e s, u ndeshen në kuadrin e kampionatit semifinal të footballit per Serbi, shoqnija sportive "Podrinje" e Shabacit me shoqnin sportive "Proleter" të Prishtines. Loja përfundoi 1:0 në favor të shoqnis sportive "P r o l e t e r".

PRIZREN:

Këshilli i manifestimit fiskultural pranë Bashkimit fiskultural per rrethin e Prizrenit po pregatitet me seriozitet per manifestimin e fiskulturistave të këtij rrethi. Në manifestim do të marrin pjesë 1400 fiskulturista. Mbas manifestimit do të jepet akademija fiskulturale.

MITROVICE:

Me qellim t'organizimit sa ma të mirë të manifestimit fiskultural të fiskulturistave të këtij rrethi, këshilli i manifestimit në Mitrovicë po formon ekipe që u shtrojnë degët e ndryshme e parapame për manifestim. Deritash janë formue dhe po pregatiten: ekipa per marshin partizan, ekipa baciklistike, ekipa e modelimit dhe ekipa e rrëshqitjes në ski, e cila do të marrë pjesë vetem në paradë. Në manifestim do të marrin pjesë 1500 fiskulturista te këtij rrethi.

FERIZAJ

Fiskulturistat e rrethit të Ferizajt po pregatiten me hov të madh per manifestimin fiskultural. Asht tue u mbarue fusha e re sportive ku do te mbahet manifestimi. Në ndreqjen e kësaj fushe per çdo të djele punojnë nga 400 të rij, frontista e sindikalista.

Ne veren e ketij viti Drejtorati Arsimuer do te hape ne Prizren kursin pedagogjik per mesues shqiptar

Tue e ndie nevojen e madhe që ka populli i Krahines s'onë për arsim e tue qenë se ende shum katunde nuk i kanë shkollat e hapuna në mungesë të mësuesve, Drejtorati Arsimuer i Këshillit Krahinuer do të hapë në Prizren gjatë verës së këtij viti kursin pedagogjik me këto tri seksione:

a) Seksjoni për provimin e pjekunis.

b) Seksjoni pedagogjik për mësues që s'kan shkollë normale ase ndonji kurs pedagogjik dhe,

c) Seksjoni i kulturës së përgjithshme për mësues t'emnuem tash vonë e që nuk e kanë kualifikimin e duhun

Me hapjen e këtij kursi do të kemi tri përfitime kryesore: së pari, që nji pjesë e mësuesve tue e dhanë provimin e pjekunis, kualifikohen, kështu që kontributi i tyne në dobin e kolektivitetit do të jetë ma i madh; së dyti, që ata mësues që nuk e kanë krye shkollën normale a ndonji kurs pedagogjik, gjatë kursit pedagogjik, do t'a mësojnë dhe përvehtësojnë edhe ma mirë detyren e mësuesis; dhe së treti, ata të tjerët të pakualifikuem e që janë emnue tash vonë, do të fillojnë me u-njoftë ashtu si duhet me mësime teorike dhe praktike, kështu që për vitin e ri shkolluer do të jenë në gjendje me u-ba mësues ma të mirë dhe ma me pak të meta aftësije.

Asht karakteristik fakti që me kujdesin e pushtetit populluer dita ditës, dhe vit për vit po përmirësohen kushtet arsimore dhe gjithnji po rritet rrjeta e shkollave popullore në Krahinen t'onë

Flamuri kalimtar - ndere dhe lavdi pune per klasen e tete Normale te Gjakoves

Mbrrijti koha qe me padurim e pritshin te gjithe nxanesit normalista konferencen, ku do te vendosej se ciles klase do t'i dorzohej flamuri kalimtar.

— Ne paraqitjen e rendit te dites prej kryetarit te rinis se shkolles t'one, si mue, ashtu edhe shokve te klases, na interesonte ma teper se ciles klase po i dorzohej flamuri kalimtar, simbol i punes shkollore dhe i akcjoneve te ndryshme.

Ne baze te shqyrtimit te referateve te tri klaseve te shkolles s'one — flet nji i ri nga komisjoni i zgjedhun prej nxanesve-konstatuem se rezultatet ma te mira nder mesime e ne pune i paska klasa e tete, prandaj kesaj i takon flamuri kalimtar.

Nderkaq ndihen duer-trokitje te parreshtuna. Ne ftyrat e te rijve te klases se tete dallohej gezimi qe paraqitete mundin dhe djersen e klases se tete.

Tue marre flamurin kalimtar kryetari i rinis se grupit t'one u-shpreh me keto fjale.

„Klasa e jone si flamurtare e shkolles normale, paraqitet sot faqebardhe para sekretarjatit e, une n'emen te shokve te mij premtoj se flamurin kalimtar s'do ta leshojme gjate vjetit shkolluer dhe se u shpallim gara per muejin prill te gjitha klasave te shkolles s'one, si ne mesime ashtu edhe ne te gjitha akcjonet e ndryshme qe ka me na paraqite organizata e rinis".

—Propozimi i shokut t'one u-pranue prej te gjithe shokeve dhe u-percuell me duer-trokitje.

Me ket rast sekratarijati i rinis shkollore iu dhuroi nxansve sulmuesa nga nji liber.

Ma ne fund flamurin e vendosem ne faqen e murit ma te dukshem te klases dhe afer tij parollen me keto vargje:

Qe flamuri kalimtar,
Simbol i mundit t'one,
Tregon hovin fitimtar,
N'pun'e msime, gjithmone.

Ne keto vargje shprehet gezimi qe ndijne nxanesit e klases se tete normale per fitimin e flamurit kalimtar, pasqyre e veprimtaris se tyne dhe shembull qe duhet te ndiqet prej te gjitha klaseve te shkollave te ketij rangut, si dhe prej atyne te bujqesis, ne Krahinen t'one.

Ali Hadri

Shkolla pedagogjike e Gjakoves u-pajis me nji toke te mire

Ne shkollen e re, praktika nder mesime e luen rolin kryesuer per edukimin e pionerve dhe te Rinis s'one. Shkolla, jo vetem qe e ka per detyre me e pajise nxansin me dijeni te gjithanshme, por edhe me ia zhvillue shpirtin praktik, ne menyre qe dijen e tij me e perdore ne jete per te mire te shoqnis

Shkolla e jone duhet te nxjerre udheheqsa te palodhun per kryemjen e Planit t'one pesvjeçar, duhet te nxjerre njerez t'afte per vnedosjen e socjalizmit. Per realizimin e te gjitha ketyneve nevojitet praktika ne pune. Ne shkolle nji nga mjetet ma kryesore per ket qellim asht kopshti shkolluer; n'ate nxanesit njifen me toke, me bimet e me punen qe lypin ato. Nxanesit do te shofin ne natyre se si permirsohet toka, si shtohet prodhimi. Ky mjet asht edhe shum ma i nevojshem per shkollat pedagogjike, prej te cilave dalin mesuesit e rij, qe te shperndame nder katunde te ndryshme, do t'i vijne ne ndihme katundarit t'one ne punet bujqesore: tue e mesue, keshillue e tue i dhane shembull me kopshtin shkolluer.

Shkolla Pedagogjike e Gjakoves mjetin kaq te vlefshem per praktiken e mesimeve nuk e ka pase. Mesimi i bujqesis deri tash asht zhvillue ne klase i thate e pa u-vue ne praktike. Kjo e mete e madhe u-plotsue per gjithnji. Ne nji vizite qe i bani shkollave te mesme ne Gjakove si dhe internatit, shoku Xhavid Nimani i njoftoi drejtorit te shkolles pedagogjike se nji are prej 1. 75 hektari qe familja e tij e posedonte ne krahun e majte ne te dale te qytetit, ne rugen e Pejes, ia fali e shkolles per nevojat praktike te nxanesvet si edhe per internatin.

Rinija e shkolles, porsa e muer vesh ket gjest bujar t'udheheqesit t'arsimit, me nji here te rradhitun e tue kendue shkuen per me e pa token ne fjale dhe atje ia filluen punes per pregaditjen e saje per mbjellje.

Rinija e shkolles pedagogjike te Gjakoves, kete ndere qe ia ka ba udheheqsi i saje, nuk ka me ia harrue kurre.

T. H.

PRISHTINE:

Ne shtatorin e vitit te kaluem ne Prishtine ka fillue nga puna shkolla e mesme teknike e ndertimeve. Ket shkolle e ndjekin 109 nxanesa: 23 shqiptar e 86 serb e malazez. Organizata e rinis se kesaj shkolle perpiqet me te gjitha fuqit e veta qe nxanesit e kesaj shkolle te korrin sa ma shum suksese nder mesime dhe te fitojne dije dhe njohuni te plota mbi degen qe ndjekin.

Klubi debat punon mire. Ne klube perpunohet dhe studjohet materjali i çmueshem, si b. f. referati i Marshalit Tito ne Kongresin e II-te te Frontit Popullüer te Jugosllavis, referati i Zhdanovit, konkluzat e mbledhjes se VIII-te plenare te Kuvendit qendruer te rinis popullore te Jugosllavis dhe detyret e rinis gjate vitit 1948 etj.—

Nuk ka shum kohe kur grate t'ona nuk kane bajte ferexhe - thot plaku Reshit Sadri Grçina

Te paket jane ata njerez qe jetojne te tane nji shekull. Reshit Sadri Grçina nga Gjakova, thote se ka le para 120 vjetve. N'anen tjeter populli thote se ky asht njeriu ma i vjeter ne Gjakove dhe se ka 102, 105 ose 110 vjete, por kurkush nuk e din me saktesi vjetin e lindjes se plakut Reshit Sadri Grçina.

Shum mbreten e qeveritare, pashallare e agallare kane qene edhe kane shkue gjate jetes se Reshit Grçines. Ky plak ka pa gjete jetes se vet, shum vuejtje dhe mjerime te popullit te rrethit te Gjakoves.

Atij i kujtohen Abdullah Pasha, Maxhar Pasha, Shaqir-Ag Curri, Bajram Ag Batusha, te cilet tue u-ende gjithmone me kuaj te shales i sillshin verdalle çifcijte e vete ane e mb'ane rrethit te Gjakoves. Te gjithe keta jane vra nga populli i ketij rrethi.

—Nuk ka qene kahere, me tahmin para 50 vjetve — tregon Reshiti, kur grate e Gjakoves mbajshin terlik e havli, keshtu qe vetem anat e kres ishin te mbulueme. Ferexhen e kane prue muhaxhiret nga Turqija. Se pari ne Shkup, mandej ne Prishtine e Mitrovice. Avdullah Pasha, Mehmet Pashe Dreni, Sejfi Pasha dhe tuxharet ua kane veshe ma te paret ferexhen grave te veta. Atehere femnat shqiptare te Gjakoves shkojshin ne fushe me mbledhe sone, pasul etj., si kurse sot qe shkojne grate e nahijes. Per grate e beglerve dhe te tuxharve ishte kollaj mbasi ato s'punojshin kurgja por vetem lyheshin dhe baheshin gadi per me e prite burrin ne harem. Mirepo, ferexha per se shpejti u-ba mode. Agallaret thojshin: „vetem fukaraja bajne terlik e havli, e efendileret duhet t'iu blejne ferexhen hanemllareve te tyne. Nuk asht musliman asnji burr, grueja e te cilit nuk bane ferexhe. Tuxharet menzi e priten kete dhe me nji here i mbushen dyqanet me basma te zeza, qe i shitshin shum mire. Kjo fare basme ne fillim ishte ma e shtrejte se basma e terlikut por mbas pak kohe terliku u-ba shum ma i shtrejte. Kjo bani qe edhe fukaraja te blejne basem per ferexhe. Vetem grate e atyne ma te kputunve qe ishin te shterngueme me punue me pare, nuk veshen ferexhe. Begleret nuk i shtijshin ato me veshe çarshafin mbassi iu duheshin per rrogtare te lira.

Plaku Reshit Grçina jeton tash nen kushte krejt te tjera. kane kalue begleret dhe agallaret. Reshitin sot e mban pushteti populluer, mbassi asht i vobeget. Ka ndie se me 8 mars e kane hjeke çarshafin 216 gra te Gramaçelit, e din se 1500 gra te Gjakoves nuk e bajne ma carshafin dhe ketij nuk i duket kjo gja e jashtezakonshme.

—Sot jane ligjet dhe zakonet ma te mira thote ky — Terrori i turqve dhe zakonet e tyne i takojne se kaluemes s'i dhet.

Vlladimir Majakovski

Kah fundi i shekullit XIX-te u-paraqite ne skenen e historis, me fuqin e plote dhe me tane bukurin e tij, heroj'i proletarjatit-prijs i popullit punonjes dhe arradhe e tij sulmuese i cili pregatitej per luften e vendosun per marrjen e pushtetit, per asgjasimin e shoqnis kapitaliste dhe ndertimin e socjalizmit. Ne dyert e historis trokiti koha e re.

Ćfaqjen e kesaj kohe te re, luften e popullit punonjes per shoqnin socjaliste, herojt e kesaj lufte ne mbare boten, e sidomos ne Rusi, ku filloi revolucjoni socjalist,- e shprehi dhe e pikturoi Maksim Gorki me tregimet, dramat e romancat e tija, e Vlladimir Majakovski e kendoi me poezinat dhe poemet e veta.

Vlladimir Majakovski lindi me 1893 ne katundin Bagdadi (tash katundi Majakovski) te Gruzis, ku baba i tij punonte si ruejtes pyejesh. Qysh ne moshen shtatevjeçare, baba i tij filloi me e dergue per kontrollimin e pyjeve. Revolucjoni i pare rus i 1905-tes e gjeti ne qytetin gruzjan Kutaisi, ku mesonte ne gjimnaz. Qe kur ishte 12-vjeçar, Majakovski lexon libra revolucjonare dhe siç thot ai vete, qysh atehere e ka banite per te tane jeten e tij aftesija e socjalistave per me i (zgjidhe faktet dhe me e spjegue jeten shkencatarisht. Ne Kutijas, ky, lidhet me marksista dhe punon aktivisht.

Me vdekjen e babes se tij, me 1906 familja e vet shperngulet ne Moske ku ky bjen ne lidhje me revolucjonaret e Moskes. Mbas vdekjes se babes, ne familjen e tij mbretnoi skamja e rande: „mbas varrosjes se babes mbetem me 3 rubla" shenoi Majakovski ne ditarin e tij. Ne Moske Majakovski vazhdon gjimnazin bashke me dy motrat e tija e, nana e vet leshonte dhoma me qira dhe u bante gjelle studentave te vorfen, e keshtu mbante femijt e saje. Ky shoqnohej me studentat qe banojshin ne shtepin e tij, ndigjon me vemendje dhe shenon pika te randesishme te diskutimeve ndermjet shokeve. Qysh ne moshen 13 vjeçare ky lexon „Anti-Dyringun" e Engelsit e ne moshen 14 vjeçare Marksin, Lenjinin („Dy taktikat) e Hegelin.

Kah fundi i vitit 1907 ky bahet antar i organizates se mshehet te Partis social-demokratike puntore (bolshevike) te Rusis. Ne vitin 1908 perjashtohet prej gjimnazit sepse, nuk kishte me e pague taksen shkollore.

Per punen e tij revolucjonare burgoset tri here me rradhe. Heren e fundit ndrron tre burgje, njeni ma i veshtire se tjetri, sepse nder te burgosunit politike zhvillon propagande te gjane revolucjonare.

Mbassi lirohet prej burgut, i kushtohet krijimit t'artit te ri revolucjonar.

Ne poezin e tij para revolucjoni, Majakovski pershkruen njerin qe vuen dhe i ban hore ata per shkak te te cilve vuen njeriu. Majakovski shkroi ne ket periudhe poezina tallese kundra kapitalistave, kundra kultures e moralit te tyne, kundra gjykatsave e nepunsave te tyne. Keto vjershа jane plot pezmatim, tallje e demaskim.

Majakovski mbaroi periudhen e pare te veprimtaris poetike me demaskimin dhe perbuzjen e kapitalizmit. E perfundoi njikohsisht tue paralajmerue revolucjonin e shpejte.

E kur erdhi revolucjoni, kur populli punonjes i Rusis, i udhehequn prej Lenjinit e Stalinit, uçue ne Tetorin e 1917-es per me i permbyse kapitalistat e aristokratet nga pushteti dhe me e marre fatin ne duert e veta — Majakovski e perfundoi revolucjonin me enthuzjazem te madh dhe u-ba poet i tij i flaket, e konsideroi vehten, "ushtar te cilin e ka fitue e mobilizue revolucjoni".

Dhe me te vertete ne revolucjon Majakovski punoi me te gjitha forcat e veta te pashterreshme. Te tane energjin e tij e shkriu ne vargje per atdheun dhe luften e vet, per socjalizem. Ne poezin e tij çdo gja ndryshohej gradualisht — edhe portoganisti i saje, edhe forma e saje. Njeriu qe vuente u-kthye ne njeri qe lufton e krijon: vargu-klithme, i shkeputun, nervoz, i pakjarte u-transformue ne lum depertues, te kthjellte si loti, i cili çan rrugen ne jete, kah ardhmenija. Majakovski kremtoi revolucjonin dhe vepren e tij çlirimtare krijonjese, kendoi prisat dhe herojte e tij, kendoi luften e punen, ndertimin e socjalizmit, kendoi per gezimin e punes, socjaliste, per krenarin e qytetarit sovjetik, per njerzin dhe bukurin e formave te reja te jetes dhe marredhanjeve te njerzve. Majakovski, si „prijs dhe sherbyes i popullit", luftoi me vargun e tij te ndritshem per suksesin e çdo ndermarrje sovjetike — n'industrijalizimin, ne politiken e jashtme e te mbrendeshme, ka forcue vllaznimin e bashkimin e popujve sovjetik, luftoi per trimnin, kulturen dhe madheshtin e rinis sovjetike. Me vargun e tij — shigjete, demaskoi kapitalizmin botnuer, veprat kriminale te tija, tyranin dhe influencen shkatrrimtare kapitaliste mbi njeriun, luftoi kundra te gjitha mbeturinave kapitaliste ne Bashkimin Sovjetik, kundra byrokratizmit e nepunsave etj.

Gjate luftes civile ka shkrue shum pllakate propagandistike e satirike, me te cilat i therrte anmiqet e Rusis Sovjetike. Ka shkrue nji mori kryeveprash te pakrahasueshme te poezis politike.

Nder veprat e tija ma madheshtore jane edhe vargjet qe i ka shkrue mbas udhtimit te tij neper Europen prendimore e neper Amerike: „Pa[illegible]" (1924-25), „Vargjet mbi Ameriken" (1925), „Atje dhe mbrapa" (1928-29).

Suksesin ma te madh e korri Majakovski me poemat e tija „150.000.000 (me 1920), „Per ate gja" (me 1923), „Vlladimir Iliq—Lenjin" (me 1924) dhe „Mire" (me 1927) ne te cilen ka shprehe me fuqi te [illegible] ne madhshtin historike te Revolucjonit te Tetorit dhe te prijsit te tij, Lenjinit, [illegible] shpirtnore dhe bukurin e njeriut sovjetik, i cili mpron vendin e tij dhe idealet e nalta qe i perkasin mbare njerzimit.

Randesija e veprave te tija asht shprehe ne fjalet e Stalinit:

„Majakovski ka qene dhe mbetet poeti ma i mire e ma i talentuem i epokes sovjetike".

Nga situata nderkombetare

Imperijalistat amerikan bashkepunojne haptas me Spanjen e Frankos

Kapitali ekspansjonist i SH.B.A. perpiqet me e ba Gadishullin e Pireneut baze ushtarako-stratigjike. SH.B.A. kerkojne prej Frankos e Portogalis se Salazarit baza ushtarake e detare. Keto kerkesa shtrihen edhe ma larg kerkohen kolonit e Spanjes dhe te Portogalis. Deri tash ka kalue ne duert e imperjalistave amerikane nji seri e tane bazash ushtarake e detare si dhe degesh kryesore t'industris se Spanjes e Portogalis. Ne shenje shkembimi me kto baza SH.B.A. i kane dhane Frankos e Salazarit huana e kredite. Veç kesaj, me qellim qe t'a zgjanojne influencen e vet, bankaret amerikane i ofrojne Frankos ndihma per t'a çduke levizjen çlirimtare ne vend dhe per t'a likuidue levizjen republikane perjashta.

Perpara, ky bashkepunim ndermjet Volstritit e Frankos ka qene pak e shum i meshehte e ne ditet e fundit krejt i hapte. Dhoma e perfaqsuesve ne marreveshtje me Spanjen e Frankos e me Shtepin e Bardhe, pat aprovue projekt-ligjin mbi perfshimjen e Spanjes ne „familjen e 16 shteteve te „planit Marshall", por tue u-frigue nga revolti i fuqive demokratike te botes u-detyruen me e terhjeke.

Forcat demokratike te te gjitha vendeve, sidomos te vendeve t'Europes Prendimore, e gjykuen ashper perfshimjen e Spanjes se Frankos ne „planin Marshall", Mirepo kte qe e bane forcat popullore dhe shtypi demokratik, laburistat angleze e socjalistat e Blumit nuk paten guxim as me e provue. Kjo ndermarrje e financjareve amerikane si dhe ndigjesa e klyshve te tyne n'Europen Prendimore e skjaron ne tanesi rolin trathtar te qarqeve qeveritare t'Europes se Prendimit, te cilat pajtohen me çdo kerkese te Washingtonit. Pranimi i „ndihmes" per shtetet e Europes Prendimore, perfshimja e Gjermanis Prendimore dhe e Spanjes se Frankos ne „planin Marshall", si dhe krijimi i paktit ushtarak prendimuer, tregon se imperjalistat amerikane hartojne plane si e si, me ane te militaristave gjermane e falangistave te Frankos te luftojne edhe kundra „agresjonit te mbrendshem", ne realitet kundra fuqive demokratike. Tentativat me e fute Spanjen e Frankos ne listen e „ndihmes" ne kuadrin e „planit Marshall", deshtoi.

Krimet mbi popullin grek jane ba i vetmi ligj i imperijalistave amerikan

Perdite e ma teper monarko-fashistat terorizojne popullin grek. Ne pjesen e okupueme qe gjindet nen qeverin e Sofulisit, nuk ekziston kurrfare lirije. Arrestimet masovike te patriotve n'Athine, Selanik e pjese tjera te vendit, pushkatimet e simpatizuesve te qeveris demokratike te gjeneralit Markos, ky asht ligji te cilin e kane shpalle okupatoret amerikane si te vetmin te plotfuqishem ne Greqi. Gjenerali Wan Flit, shef i misjonit ushtarak amerikan n'Athine, perkah metodat e tija te çfarosjes se popullit, perkah instruksjonet qe ua jep bandave monarko-fashiste, nuk ndryshon aspak nga gaulajteret fa me-keqe te Hitlerit. Parimi i tij: „zene rob e vraje!" asht ba i vetmi ligje te cilin e praktikojne per dite monarko-fashistat per t'a shue luften çlirimtare te popullit grek. Masat e ketilla brutale, te cilat u-leshue me i mprojte haptas i pari gjykatsi amerikan Wenerstrum ne Nirenberg, tue mprojte gjeneralat hitlerjane, nuk ndryshojne aspak nga inkuizicjoni i shekullit te mesem.

Ne shekullin e mesem jeniçeret e lidhshin popullin e paperkulshem ne bishtnat e kuajve dhe e copetojshin keshtu, e ne „shekullin atomik" te Trumanit gjeneralat amerikane i shkyejne patriotet grake me mjete moderne, me aeroplana. Kriminelat hitlerjane kane mbyte me qinda mija burra, gra e femij ne qeliza gazmash helmuese, e monarko-fashistat, nen komanden e oficerve amerikane, kane perdore gazma helmuese per t'a shue luften e armatosun te popullit grek. Kriminelat hitlerjane nuk kane pase aq guxim sa pasur dhe te tyne te Wolstritit ne Greqi. Okupatoret amerikane, gjenerali Wan Flit dhe oficerat e tij ua kaluen me krime krijuesave te „rendit te ri europjan".

Intervenimi amerikan ne Greqi, ndihma sa do e madhe qofte ne arme e municjon, nuk mund te shpetoje pozitat e trondituna te monarkofashistave. Ket e tregojne sukseset e Armates Demokratike ne te gjitha vendet e Greqis. Ket e tregon gjithashtu lufta per here ma e forte e popullit grek per t'i perzane okupatoret anglo-amerikane dhe per t'a likuidue agjenturen e tyne n'Athine.

Lufta Çlirimtare e popullit Kinez

Simbas lajmit te korespondentit t'agjensis „Kina e Re" e gjithe pjesa qendrore e krahines Shantung si dhe gadishulli Shantung gjinden ne duer te reparteve t'Armates Nacjonal-Çlirimtare, me perjashtim te tri qyteteve t'izoluerne.

Afer 20 brigada te Çang Kaj Shekut jane shtye ne breg-detin jug-lindor te gadishullit. Mandej njoftohet se per evakuimin e familjeve te funkcjonarve te Kuomintangut nga qyteti i rrethuem Cingao jane perdore 200 ajrore te prodhimit amerikan.

Agjensija „Frans Pres" njofton se Cangajsheku ka mbajte nji fjalim n'asamble, ku ka pohue se qeverija ka humbe 17 divizjone, 7 prej te cilave vetem ne Mançuri. Mandej ky ka thane se me qellim te shkurtimit te frontit do te terhiqen trupat qeveritare nga te gjitha vendet e parandesishme e se do te perdoren vetem per mprojtjen e qendrave te randesishme politike.

ÇEKOSLLOVAKI

(PRAGE) Ne Prage u-nenshkrue marrevveshtja ndermjet Qeveris se Çekosllovakis e Bullgaris mbi shkembimin e mallnave tregtare dhe pagimin e tyne per vitin 1948.

Ne kryeqytetin e Kolumbis ka plase kryengritja e armatosun

Agjensija „Asoshieted Pres" njofton se me 9 te ketij mueji ka plase kryengritja e armatosun ne kryeqytetin e Kolumbis, e per ket arsye konferenca pan-amerikane, qe ishte tue u-mbajte n'ate vend, u-shtye per nji kohe te pacaktueme.

Kryengritja ka plase mbas vrasjes s'udheheqsit te shquem te partis liberale — Jorgo Elisjera Gaetan, qe e vrane aderusit e partis konservatore - qeveritare. Turmes se qytetarve, qe udhehiqej nga krenet liberale, i u bashkue ushtrija dhe n'oret e para te mbasdites u-pushtuen nji numer i madh ministrinash dhe radio-stacjonin.

Rajteri njofton se me anen e radjo-stacjonit te kryeqytetit i asht drejtue nji apel populisis se Kolumbis ku thuhet se partija liberale ka marre ne dore pushtetin e kryeqytetit dhe se liberali i shquem Dr. Daria Ençanda asht emnue per kryetar te perkohshem te republikes dhe pritet qe per se shpejti te njoftoje formimin e qeveris se vet. Kjo agjensi, gjithashtu lajmeron se konfederata e punes ne Kolumbi ka shpalle greven e pergjithshme ne mbare vendin. Keshilltari i konfederates se punes Karlos Hern Pareh i ka ftue te gjithe elementat perparimtare, e ne rend te pare puntorin, qe t'armatosen dhe te bashkohet me kryengritsat. Ky ka lajmerue se kryengritja popullore po merr perpjestime gjithnji ma te mdhaja dhe se me kryengritsat jane bashkue fuqi bekur te mdhaja ushtarake dhe policore.

Ne lajmet thuhet se me rastin e perleshjeve neper rruget e kryeqytetit dhe te demostratave masovike, n'ambasaden amerikane asht hedhun bomba dhe kercnohet zjarri, qe po zgjanohet gjithnji n'ate pjese te qytetit.

Agjensija Frans Pres ne lajmin e fundit njofton se kryengritsat i kontrollojne te gjitha vendet e randesishme te Kolumbis dhe se pjesa e madhe e delegacjonit pan-amerikan po pregatitet me u-largue nga kryeqyteti Bogota.

Merret vesht se ministri i jashtem i SH. B. A. Marshall, i cili gjithashtu ndodhet ne Bogota, kerkon qe konferenca pan-amerikane te vazhdoje nga puna ne Vashington. (Tanjug).

Qeverija e de Gasperit po e terorizon populisin demokratike italjane

ITALI

Sa ma afer dites se votimeve te pergjithshme n'Itali, aq ma teper e ma tmerrsisht po e terorizon populisin demokratike italjane qeverija e de Gasperit. Vetem ne keto ditet e fundit ne Siçili jane vra 35 udheheqesa sindikalista. Populisija e ishullit Pantileria asht randue aq teper me tatime sa shumica ka rroke strajcen e shkopin dhe po lype sokaqeve ndihme e meshire.

Ministri i policis Shelba ka deklarue haptas keshtu: „Mjere ata qe votojne per Frontin e demokracis popullore". Per te ba „kontroll" ne votime, qeverija e de Gasperit ka mobilizue 330.000 polic e t'armatosun me arme moderne, e 150.000 milic te milicis se motorizueme, jane pajise me karro te blindueme amerikane dhe me arme automatike. Kjo polici asht gadi me ia fillue operacjonit „atje ku ta lype nevoja".

Nga nji ane kandidatet qeveritare mbajne fjalime provokuese tue ftue popullin italjan „per t'a mprojte demokracin prej bolshevizmit" dhe per ta ruejte „paqen" e popullit italjan, nga ana tjeter organizohet komploti i gjane fashist me qellim qe, tue gezue ndihmen nga jashte, t'i jape grusht Frontit demokratik populluer dhe te fitoje pa tjeter ne votime. Ket komplot e organizuen gjeneralet e oficerat e nalte t'ushtris italjane ne krye me ish mareshalin e Musolinit, Meseun, bashke me sherbimin e mshefte informativ amerikan, me „intelixhens servisin" englez dhe me Vatikanin. Partinat fashiste kane fitue sasina te mdhaja materjali dhe armesh. Nji sasi e madhe kesi materjali luftarak e armesh asht gjete ne nji anije afer Barit. Megjithse qeverija e de Gasperit u-mundue me ia ngarkue Jugosllavis, u-vertetue se keto arme jane dhurate e pushtetit okupues amerikan te Triestes per fashistat italjane dhe de Gasperi u-detyrue me e pohue te verteten.

Kurrfare provokimesh nuk ia thyen popullit italjan frymen dhe besimin e plote ne fitoren ne votime. Populli italjan qendron i forte ne mprojtjen e paqes e Republikes.

HUNGARI

Demokracija e re hungareze bani edhe nji hap te madh perpara ne rruge drejt socjalizmit. Keshilli ministruer aprovoi projekt-ligjin mbi nacionalizimin e sipermarrjeve te minjerave e industrijale, ne te cilat punojne ma se 100.000 puntore. Ne ket menyre perveç sipermarrjeve te nacionalizueme deri tash, kalojne ne duert e popullit edhe afer 500 sipermarrje tjera, qe don me thane se populli hungarez po bahet zot i pjeses ma te madhe t'industris hungareze.

B.R.S.S.

Me 6 prill u-nenshkrue ne Moske Pakti i miqsis, bashkepunimit e ndihmes reciproke ndermjet Bashkimit Sovjetik e Republikes Finlandeze. Nenshkrimi i ketij Paktit asht edhe nji kontribut i madh dhe fitore ne lufte per paqen dhe sigurin e popujve. Pakti ndermjet Bashkimit Sovjetik dhe Finlandes jo vetem u sherben interesave te zhvillimit te marredhanjeve miqesore te ketyne vendeve, por kontribuon edhe ne konsolidimin e paqes n'Europe.

Eksperienca e idhet e mesoi popullin finlandes se vetem marredhanjet e mira fqinjesore dhe miqsija e bashkepunimi me Bashkimin Sovjetik mund te sigurojne forcimin e pamvaresis kombtare dhe sovranitetit shtetnuer te Finlandes, se vetem keto marredhanje mund te sigurojne zhvillimin e qete te jetes se saje ekonomike e kulturore.

HUNGARI

(Budapest). Mbrojtja e shtetit Hungarez zbuloi organizatat fashiste te Rongjoshgardit, e cila ka organizue komplotin kundra Republikes Hungareze. Prijsat e kesaj organizate, tregtar'i madh Llasllo Drashkovi dhe ish pronari i madh Bella Hajc, me ndihmen e jashtme, deshten me e zhduke Qeverin Demokratike te vendit dhe me marre pushtetin ne duer te tyne.

Prage

Delegati çekosllovak n'Organizaten e Kombeve te Bashkuem Houdek i dorezoi Trigve Liut, sekretar gjeneral i kesaj Organizate, pergjigjen e qeveris çekosllovake me te cilen Çekosllavakija refuzon me marre pjese ne diskutim mbi ankesen çpifse te Çiles-

Pariz

Ne konferencen nderkombetare per ndihma Greqis demokratike, u-aprovue unanimisht rezoluta me te cilin denohet ashper intervenca ushtarake, politike e materjale amerikane ne punet e mbrendeshme te Greqis.-

SHEMSI

Simbas lajmit t'Agjensis "Kina e Re", Armata demokratike e Kines gjatë muejit truer ka qitë jashta përdorimit 100.000 ushtarë e oficera të Kuomintangut, ndër të cilet gjinden edhe 7 gjenerala. Mbrenda po kësaj kohe Armata demokratike e Kinës ka çlirue 36 qendra krahinore dhe ka zanë sasina të mdhaja armësh, municjoni etj.

ROME

Në mitingun paraelektroral të Frontit demokratik populluer t'Italis që u mbajt në Milano, foli Palmiro Tolljati, sekretar gjeneral i Partis Komuniste t'Italis. Në fjalimin e tij theksoi se Fronti demokratik populluer mpron lirin e popullit italjan dhe tha se masat e katundarve, puntorve e intelektualve, të bashkueme në Frontin demokratik populluer duen me e drejtue ato vet vendin e tyne për t'i realizue reformat demokratike në strukturën e shtetit dhe për ta ba Italin të lirë e të pamvarun.

Botim i Këshillit Krahinuer të Frontit populluer; Shtypshkronja Krahinore «PROGRES»
Pajtimet në fletore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çdo [illegible]